



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 535 prot.

Gramsh, më 02/02/2024

VENDIM
Nr. 7 , datë 26.01.2024

Për disa ndryshime në “ Rregulloren e Funkionimit të Këshillit Bashkiak” dhe ngritjen e Komisionit të Përhershëm “Komisioni i Integrimit Europian”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 26.01.2024, mbështetur në ligjin nr.139/2015, date 17/12/2015, "Per Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2, neni 9 gërma "b", neni 54 gërma "a" si dhe Neni 176 i "Rregullores së Funkionimit të Këshillit Bashkiak",

VENDOSI:

- 1- Ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr 46/a datë 01/06/2020 për miratimin e “Rregullores së Funkionimit të Këshillit Bashkiak”, si më poshtë:
 - a- Në nenin 32 “Emërtimi i Komisioneve të Përhershëm” shtohet pika 10 :
Komisioni i Integrimit Europian.
- 2- Miratimin e Komisionit të Përhershëm “ Komisioni I Integrimit Europian” pranë Këshillit Bashkiak ,me përbërjen e anëtarëve nga radhët e këshilltarëve si më poshtë:
 - a- **Komisioni i Integrimit Europian** përbëhet nga 3 këshilltarë, ku përbërja e komisionit respekton edhe kërkesat e barazisë gjinore.
 1. Enis Zani, Kryetar
 2. Ardiana Hasa , Sekretar
 3. Greta Lena, Anëtar
- 3- Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen kryetarët e komisioneve të përhershme dhe Kryetari i Këshillit Bashkiak.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT
Enis ZANI

